



Dalës-Izlazn:

Nr. I-151  
B.:

Data 30.11.2023  
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obilić

Në bazë të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), nenit 58 shkronja (h) nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligjit Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenit 72, pika 1.8 dhe nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.I-34 i dt.25.04.2016, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-1661, të dt.21.11.2023, në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Milloshevë dhe Obiliq

Neni 1

Miratohet Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale si në vijim :

- **P-72614055-00066-1**, Lloji i Njësisë:Parcelë: Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Tokë Tjetër ; Shfrytëzimi actual I parcelës: Jo pjellore; me sipërfaqe prej 136696 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq ;vendi i quajtur:"Aerodrom" e cila evidentohet në emër të **KEK Sh.a.** ;
- **P-72614055-00066-2**, Lloji i Njësisë:Parcelë: Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Tokë Tjetër ; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Jo pjellore; me sipërfaqe prej 1470 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq ;vendi i quajtur:"Aerodrom" e cila evidentohet në emër të **KEK Sh.a. dhe ;**
- **P-72614051-00836-3**, Lloji i Njësisë:Parcelë: Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore ; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Kullosat;kualiteti I klasës: Kullosë e klasës 2; me sipërfaqe prej 408395m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Milloshevë ;vendi i quajtur:"Njive Kod Aerodr." e cila evidentohet në emër të **KEK Sh.a.** ;

Neni 2

Qëllimi i paraqitjes së këtij Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të njësive kadastrale të cekura si në nenin 1 është se njësitë në fjalë paraqesin një pozitë të mirë gjeografike dhe strategjike ku investitorët e ndryshëm nga mbrenda dhe nga jashtë mund të shprehin interesim për të investuar në Komunën e Obiliqit, siç është rasti i Kompanisë Angleze Chayton Capital e cila planifikon të realizojë projektin e saj në Komunën e Obiliqit.

Neni 3

Bazuar në parimin e konkurrencës, këta investitorë do të kenë mundësinë e ofertimit për realizimin e projekteve të tyre në Komunën e Obiliqit, ku Komuna synon rritjen e të hyrave komunale ku do të gjenerohen vende të reja të punës dhe përparësi do të kenë banorët e Komunës së Obiliqit.

Neni 4

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Komuna e Obiliqit planifikon që t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillimin e procedurave të mëtejme deri në realizimin e projektit në tërësi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

*Këtij Vendimi i bashkangjesim:*

- Memorandumin e MirëKuptimit Nr. II-1032 Dt.28.07.2023 e lidhur në mes të Komunës së Obiliqit dhe Kompanisë Angleze Chayton Capital ;
- Projektin e Kompanisë (Logistic Center Obiliq :
- Cerifikatën Pronësore ,Kopjen e Planit dhe Orto foton .

Ti dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi